VENDIM
Nr.124, datë 17.2.2010

PËR HAPJEN E PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË NË UNIVERSITETIN "ISMAIL QEMALI", VLORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 26 dhe 42 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Hapjen, në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë, të programeve të studimit, të ciklit të parë, në Fakultetin e Shkencave Teknike, si më poshtë:

a) "Biologji", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në biologji.

b) "Fizikë", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në fizikë.

c) "Kimi", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në kimi.

d) "Ekonomiks", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në ekonomiks.

e) "Financë", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në financë.

f) "Inxhinieri elektrike", në përfundim të të cilit lëshohet "Diplomë e nivelit të parë", DNP, në inxhinieri elektrike.

2. Këto programe studimi të ciklit të parë realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tyre është tri vite akademike.

3. Programet e studimit "Biologji", "Fizikë", "Kimi", "Ekonomiks", "Financë" dhe "Inxhinieri elektrike" ta fillojnë veprimtarinë mësimore në vitin akademik 2010-2011.

4. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i miratuar për universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

5. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës dhe universiteti "Ismail Qemali", Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha